Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ilir Halili	**15.03.2024**	**18.04.2024**	**2024/0166**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 26.02.2024, OE "Re - Publika Marketing & Media Solutions SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0166, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Re - Publika Marketing & Media Solutions SH.P.K."- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Fushata per promovimin dhe informimin mbi aktivitetet e MPB-se dhe publikimet ne media elekronike" me nr. të prokurimit: "214-23-13393-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur? t? hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontrat?s: pun?, furnizim, sh?rbim, vlera e parashikuar e kontrat?s: xx,xxx €.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2024/0166 i dt:26.02.2024.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Konsiderojmë se vlerësimi i tenderëve dhe vendimi përfundimtar është bërë në mënyrë

të kundërligjme dhe në këtë mënyrë janë shkelur dhe zbatuar gabimisht dispozitat

ligjore si në vijim:

1. Neni 1 par 1 dhe 2 i LPP-së Nr. 02/L-042, neni 4.3 i Rregullave për Prokurim

Publik;

2. Neni 7 paragrafi 1, 2 dhe 6 i LPP-së Nr. 02/L-042

3. Neni 56 paragrafi 1.1 dhe 1.2 i LPP-së;

4. Neni 59 paragrafi 4, neni 56 par.1 dhe 2, neni 60 par.1.1 i LPP-së Nr. 02/L-042, neni 40.1 dhe 40.6 i , neni 38,Rregullorës për Prokurim Publik;

5. Neni 61 par.2 dhe 4 i LPP-së Nr. 02/L-042, neni 41 par, 8, 10 -b) i Rregullorës për Prokurim Publik;

Me datën 09.02.2024 kemi marrë Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues sipas të cilit është bërë anulimi I aktivitetit. Njëherit me vendim kemi pranuar edhe letrën standarde në bazë të cilës tedneri jonë është vlerësuar si tender i eleminuar por që nuk është shpërblyer me dhënien e kontratës me arsyetimin se nuk ishte I përgjegjeshëm si dhe me çmimin më të lartë në kundërshtim em dispozitat ligjore, si dhe vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim ku janë refuzuar pretendimet tona në kundërshtim me dispozitat ligjore .

Duke u nisur nga dosja e tenderit dhe FDT, oferta jonë ka plotësuar të gjitha kushtet e dosjes së tenderit dhe ka qenë ndër tenderët më të mirë që kanë plotësuar kriterin për marrjen e kontratës.

Andaj duke pa se tenderi jonë nuk është përzgjedhur me dhënien e kontratës, për shkak të dilemave që i keni pasur.

Nga dokumentet që i kemi siguruar bazuar në DT dhe FDT kemi vërejtur se si OE i kemi plotësuar kërkësat e dosjes së tenderit, me ç'rast rezulton se gjatë vlerësimit s të tenderit lidhur me kërkesën e AK-së 29.11.2023 përkitazi me dokumentet dhe çmimet e ofruara në paramasë kami paraqit informata e kerkuara dhe të domoshdoshme sipas DT.

Për shkak të vlerësimit në kundërshtim me nenin 59.4, nenin 60 par.1.1 lidhur me nenin 61 të LPP-së dhe për shkak të vlerësimit të zbatuar në mënyrë jokonsistente për çështje të njejta në raport me OE, ne si pjesëmarrës në këtë aktivitet jemi dëmtuar nga rezultati i vlerësimit për arsye se nuk jemi përzgjedhur me dhënien e kontratës si pasojë e e

anulimit të aktivitetit dhe mos rekomandim me kontratë në kundërshtim me kërkesat ligjore të potencuara më lartë.

Pretendimi nr. 1.

Sipas vlerësimit të AK tenderi i dorëzuar nga jonës është diksualifikuar si tenderues i papërgjegjshëm duke ju referuar arsyetimit se : bazuar në DT nenin 9.1&9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ku është kerkuar : Vetëm Për Lot- I

2. Operatori ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ketë Staf profesional së paku 5 punëtor 2.1- Minimumi tre (3) persona me Diplomë Universitare në fushën e marketingut (duke filluar nga Bachelor e tutje); 2.2- Minimumi një (1) person me Diplomë Universitare në fushën e Dizajnit Grafik (minimumi Bachelor) ; 2.3 - Minimumi një (1) person Montazher - Diplomë Universitare ose Certifikatë në këtë fushë.

Dëshmia e kërkuar: 1. Lista e stafit të kompanisë e vulosur dhe nënshkruar nga OE për pikat 2.1 2.2 dhe 2.3 Diplomat përkatëse Kopje në lamin e kërkuar kontrata e punës valide ose marrëveshjen e punës për këtë projekt - kopje, ndërsa për piken 2.3 Diploma ose Certifikata-Kopje

Në Ofertën e dërguar nga ne të gjitha kërkesat me dëshmi kanë qenë të bashkangjitura, andaj në rast se keni pasur dilema apo hamendje bazuar në nenin 59 të LPP dhe nenin 38 të RRPP-ës, ju si Ak jeni dashur të kërkoni sqarime shtesë, vlersimi dhe marrja e një vendimi paduke mos respektuar dispozitat ligjore bie ndeshë dhe në kundërshtim të plotë me legjislacionin e prokurimit publik pra në kundërshtim me nenin 1 dhe 7 të LPP-së.

Pretendimi nr. 2.

Sipas vlerësimit të AK tenderi i dorëzuar nga jonës është diksualifikuar si tenderues i papërgjegjshëm duke ju referuar arsyetimit se : bazuar në DT nenin 9.1&9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ku është kerkuar: 3. Operatori ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ofrojë listën e TV dhe Portaleve të kontraktuara.

Dëshmia e kërkuar: 3. Lista së bashku me dëshmi si Kontratat ose Marrëveshjet për TV dhe Portaleve të kontraktuara-Kopje.

Duke u nisur nga parimit i barazisë, Ak gjatë vlersimit dhe ekzaminimit të ofertave , nuk ka respektuar nenin 59, paragrafi 2 të LPP-ës , ku thuhet ndër të tjera si në vijim :

2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

Po ashtu nuk është respektuar as neni 38 i RRPP-ës nr,001/2022, paragrafi 38.1 dhe 38.3 si në vijim : 38.1 Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një formular standard B47 për sqarime për të përdorur nga AK "Kërkesë për sqarim të tenderit". Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformës elektronike, dhe 38.3 Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit të Njoftimit për kontrate.

Lidhur me dispozitat tjera sekondare sipas Udhëzuesit nr.001/2023, për Prokurim Publik , nenin 10, paragrafi 10.1 , ku ndër të tjera e ka shembujt e listruar se kur dhe ku duhet kërkuar sqarime shtesë.

Andaj AK ka berë shkelje të dispoziatav të cekura të ligjit dhe rregullorës së prokurimit publik.

NË PRETENDIMIN 3: AK ka vendosur që për Llot II, të ndërlidhet se kinse është ofertuar me çmim të lartë nga Tregu.

AK në këtë rast nuk ka respektuar nenin 13, të Rregullorës Për Prokurim Publik ku

ndër të tjera AK e ka në diskrecion që të bëjë hulumtimin e tregut në mënyrë bindse , por asesi me hamendisme dhe vlersime të pa hulmtura dhe argumentuar , bazuar në nenin e lartëcekur ndër të tjera spejgohet decidivishtë se kur AK mundë ta konstatojë se një ofertë apo një pozicion është më i lartë se çmimi i tregut si : 13.1 Vlera e parashikuar e një kontratë publike duhet të parallogaritet para inicimit të procedurës së prokurimit. Parallogaritja e tillë duhet të jetë e arsyeshme dhe reale për kontratën e parashikuar.13.3 Në parashikimin vlerës së kontratës AK është përgjegjës për krahasimin e çmimeve të tregut, çmimeve të kontratave paraprake kur ato ekzistojnë, etj, me analizë të kostos të specifikimeve relevante teknike të

mallrave, shërbimeve ose punëve për prokurim.

Nga të gjitha faktet e paraqitura më lartë qartësohet dhe argumentohet në mënyrë konkrete dhe të mjaftueshme se AK-ë, gjatë Vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të ofertave nuk ka respektuar dispozitat ligjore për prokurim publik.

Në këtë kuptim nga ana e juaj gjatë fazës së vlersimit bie në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe në kundërshtim me dispozitat e ligjit të prokurimit nga nenin 59.4, nenin 60 par.1.1 lidhur me nenin 61, nenin 7 dhe nenin 1 të LPP-së dhe legjislacionit sekondar nenit 40.1, 40.6 i neni 41 par, 8, 10 -b) i Rregullorës për Prokurim Publik.

Andaj duke u bazuar në argumentet dhe provat e paraqitura më lartë, kërkojmë nga AKMinistria e Punëve të Brendshme të ndërmarrë veprime korrigjuese në pajtueshmëri me kërkesat ligjore, në atë mënyrë që të nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. APROVOHET e bazuar Kërkesa për Rishqyrtim nga Re- Publiku Marketing & Media Solutions " SH.P.K

2. ANULOHET Njoftim Vendimi i dt. 09.02.2024 për Anulim të aktivitetit dhe lënda të kthehet në rishqyrtim në atë mënyrë që tenderi/oferta e jonë në fjalë të vlersohet sipas procedurave dhe të vazhdohet me dhënien e kontratës RePubliku Marketing &

Media Solutions " SH.P.K si i vetmi tenderues i

përgjegjshëm që ka plotësuar edhe kriterin e dhënies sipas nenit 60 par.1.1 të LPP-së

KRITERET PËR VLERËSIM

	Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*

			1. Operatori ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik pjesëmarrës duhet të dëshmoj së ka projekt të shërbimeve të ngjashme të përfunduara për periudhën (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare) për LOT -1 minimum një projekt të përfunduar, dhe për Lot – 2 minimum një projekt të përfunduar€ Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për 2 (Dy) Lote, atëherë duhet ta minimumi dy projektet të pëfunduara të natyrave të ngjajshme.	**1. Një listë të projekteve të përfunc nënshkruar dhe vulosur nga OE, të kërkuar për periudhën e shkuar tre bashkëngjitur referencat ose rapor përfundimtar të shërbimeve .**

			Vetëm Për Lot- I **2. Operatori ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ketë Staf profesional së paku 5 punëtor 2.1- Minimumi tre (3) persona me Diplomë Universitare në fushën e marketingut (duke filluar nga Bachelor e tutje); 2.2- Minimumi një (1) person me Diplomë Universitare në fushën e Dizajnit Grafik (minimumi Bachelor) ; 2.3 - Minimumi një (1) person Montazher - Diplomë Universitare ose Certifikatë në këtë fushë.**	**1. Lista e stafit të kompanisë e vulo nënshkruar nga OE për pikat 2.1 2.2 Diplomat përkatëse Kopje në lami kontrata e punës valide ose marrëv për këtë projekt - kopje, ndërsa pë Diploma ose Certifikata-Kopje**

			3. Operatori ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ofrojë listën e TV dhe Portaleve të kontraktuara.	**3. Lista së bashku me dëshmi si Kor Marrëveshjet për TV dhe Portaleve kontraktuara-Kopje.**

			4. Operatori ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi për billbord digjital të jashtëm në pronësi ose me marrëveshje për shfrytëzim.	**4. Dëshmi mbi pronësi ose marrëve shfrytëzim.**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK)

B42 - Letër standarde për *tenderuesin* e eliminuar

Prishtinë: 08.02.2024

Adresa e Autoritetit Kontraktues:
MPB– Departamenti i Prokurimit
Adresa: Rr: "Luan Haradinaj", pn, ndërtesa qendrore e MPB-së, kati II, zyra 204, Prishtinë

Adresa e tenderuesit: Re - Publika Marketing & Media Solutions SH.P.K., rr. Enver Maloku nr.82, 10000, Prishtine

Nr. i prokurimit	**214-23-3197-1-3-6**

Titulli: "Fushata për promovimin dhe informimin mbi aktivitetet e MPB-së dhe publikimet në media elekronike"
Lot - I - Fushata për promovimin dhe informimin mbi aktivitetet e MPB-së
Lot - II - Shërbime dhe publikime në media elektronike për nevoja të MPB-së

I/e nderuar(a) [Z/Znj]/ _____

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".
Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *dosjen e tenderit*. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Tenderi i juaj është i papërgjegjshëm dhe është refuzuar për këto arsye:

Nuk keni dorëzuar dëshmi siç është kërkuar në Dosjes së tenderit Njoftimit për kontratë te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 dhe 9.2.

Kërkesa nr. 2

Vetëm Për Lot- I
2. Operatori ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ketë Staf profesional së paku 5 punëtor:
2.1- Minimumi tre (3) persona me Diplomë Universitare në fushën e marketingut (duke filluar nga Bachelor e tutje);
2.2- Minimumi një (1) person me Diplomë Universitare në fushën e Dizajnit Grafik (minimumi Bachelor) ;
2.3 - Minimumi një (1) person Montazher - Diplomë Universitare ose Certifikatë në ketë fushë.

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Dëshmia e kërkuar dokumentare

2. Lista e stafit të kompanisë e vulosur dhe nënshkruar nga OE për pikat 2.1 2.2 dhe 2.3 Diplomat përkatëse Kopje në lamin e kërkuar kontrata e punës valide ose marrëveshjen e punës për këtë projekt - kopje, ndërsa për piken 2.3 Diploma ose Certifikata-Kopje
Ju keni dorëzuar vetëm një listë të stafit për dhe nuk keni afruar dëshmi sipas kërkesave dhe gjithashtu keni ofruar disa dokumentacione për persona krejt tjerë të cilët nuk janë fare në listë dhe të njëjtit nuk plotësojnë kriteret e vendosura në Njoftim për kontratë dhe në Dosje të tenderit.

Kërkesa nr. 3

3. Operatori ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ofrojë listën e TV dhe Portaleve të kontraktuara.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

3. Lista së bashku me dëshmi si Kontratat ose Marrëveshjet për TV dhe Portaleve të kontraktuara-Kopje.

Ju nuk kemi ofruar asnjë listë të TV dhe Portale të kontraktuara ju keni ofruar një marrëveshje me Selmans Netwrek Sh.P.K, edhe e njëjta nuk është sipas kërkesave të vendosura në Njoftim për kontratë dhe në Dosje të tenderit dhe nuk plotëson kriteret e AK-së.

Kërkesa nr. 3
4. Operatori ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi për billbord digjital të jashtëm në pronësi ose me marrëveshje për shfrytëzim.

Dëshmia e kërkuar dokumentare
4. Dëshmi mbi pronësi ose marrëveshja për shfrytëzim.

Ju keni ofruar vetëm një marrëveshje me Selmans Netwrek Sh.P.K, mirpo nuk keni ofruar asnjë dëshmi lidhur me billbord digjital të jashtëm dhe si e tillë nuk plotëson **kriteret e vendosura në Njoftim për kontratë dhe në Dosje të tenderit.**

Gjithashtu për Lot -II
Lot - II - Shërbime dhe publikime në media elektronike për nevoja të MPB-së

Çmimet e ofruara janë ekstremishtë të larta me mbi vlerën reale të tregut dhe të njëjtat janë në kundërshtim më Neni 1 Qëllimi dhe Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti të LPP-së dhe me nenin 4 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, paragrafi 4.1 pika a dhe c, ku kërkohet nga AK si në vijim:

Neni 4 Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit.
4.1 Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë obligimet në vijim:

a. të luaj rolin aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratave, me theks të veçantë për çmimet, afatet e dorëzimit, sasitë, karakteristikat teknike dhe garancive

c. të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut,

mbështetur në arsyetimin e cekur më lartë, tenderi-oferta Juaj është REFUZUAR dhe nuk kalon në vlerësimin e mëtutjeshëm.

Pra çmimi i ofruar për këtë Lot është jashtëzakonisht i lartë dhe si i tillë është i papranueshëm për AK-në.

Prandaj, nga arsyet e cekura më lartë, oferta juaj është refuzuar dhe nuk kalon në vlerësimin e mëtutjeshëm.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni një kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në këtë letër standarde.
Edhe pse nuk kemi qenë në gjendje të punojmë me kompaninë tuaj kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.
Me respekt,

_____, _____

[Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit] *[Nënshkrimi]*

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Re - Publika Marketing & Media Solutions SH.P.K.**

Pretendimi nr.1

Pretendimi I parë ankimorë sipas ankesës 166/24 ka të bëjë me arsyen e parë të eliminimit, ku sipas AK-së OE ankues nuk ka plotësuar kërkesat e dosjes sa i përket stafit profesional.

OE ankues pretendon se i plotëson kërkesat sipas dosjes së tenderit.

Pas analizimit të ofertës së OE ankues, kemi gjetur se nga tri profesionet, Dizajn grafik, Marketing dhe montrazher, OE ankues ka ofruar dëshmi vetëm për Marketing dhe Dizajn për Komunikim, ndërsa për montazher ka ofruar disa certifikata të kurseve për editim të videove, njëra certifikatë shënon kohëzgjatja trajnimit 6.5 orë, dhe tjera me kohëzgjatje të trajnimit 30 orë.

Vlerësimi ekspertit është se kjo nuk mund të konsiderohet ekuivalente me diplomë universitare ose certifikatë të fushës siq është kërkuar në dosje të tenderit.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Pretendimi nr.2

Arsyeja e dytë e eliminimit të OE ankues, është mungesa e listës së bashku me dëshmi për tv kanale dhe portale të kontraktuara nga OE.

OE ankues ka ofruar një marrëveshje me një kompani "Selmans Netëork".

OE ankues nuk ka ofruar listë e as dëshmi për ndonjë TV apo portal të kontraktuar.

OE ankues po ashtu në ankesë nuk ka bashkangjitur sqarime apo dëshmi për të cilat pretendon se do sqaronte sikur AK të kishte kërkuar sqarime shtesë.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

E njëjta situatë është edhe për bilbord të jashtëm në pronësi ose marrëveshje për shfrytëzim.

Pretendimi nr.3

Arsyeja e fundit për eliminim të OE ankues sipas AK-së ka qenë çmimi shumë i lartë në krahasim me çmimet e tregut.

Në rastin konkret vlen të ceket se as AK e as OE nuk kanë dhënë sqarime apo krahasime konkrete se cilat janë çmimet e tregut dhe çmimet e OE ankues që përkojnë ose nuk përkojnë me çmimet e tregut.

Përderisa çmimi i OE ankues në total është nën vlerën e parashikuar për këtë tender, duhet cekur se Lot.2 nuk ka fare të përcaktuara sasi të përafërta, më konkretisht është shnuar sasia 1.

Pavarësisht mungesës të kapacitetit teknik për të zbuluar çmimet e tregut, dosja e tillë pa sasi të përafërta, mund ta sjellë autoritetin kontraktues para një situate ku buxheti/vlera e parashikuar të harxhohet edhe pa i arritur qëllimet dhe nevojat e AK-së.

Në fund shtojmë se pavarësisht faktit nëse çmimet e OE ankues janë ose nuk janë të shumë të larta, kjo nuk do të ndryshonte rezultatin përfundimtar për këtë aktivitet të prokurimit pasi OE ankues nuk ka plotësuar kërkesa tjera të FDT-së.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK për anulimin e aktivitetit te prokurimit.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Re - Publika Marketing & Media Solutions SH.P.K.**

Ilir Halili